



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë: 4.7.2023

Nr: 679

Ora: 17:30

VENDIM

PËR

DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË KUÇOVË, QARKU BERAT Z. KRESHNIK RIZA HAJDARI, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 4.7.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT:

Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, z. Kreshnik Riza Hajdari, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE:

Neni 19, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Bazuar në nenin 33, shkronja "g", Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 64, me vendimin nr. 101, datë 16.5.2023, ka shpallur fitues z. Kreshnik Riza Hajdari, si Kryetar i Bashkisë Kuçovë, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Datë: 4.7.2023 Nr: 679
Ora: 17:30



"Për dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, z. Kreshnik Riza Hajdari, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Kundër vendimit të KZAZ-së u administruan dy kërkesa ankimore:

Kërkesa ankimore nr. 67, datë 20.5.2023, me ankues subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe kërkesa ankimore nr. 74, datë 22.5.2023 me ankues z. Lefter Maliqi, kandidat i koalicionit “Bashkë Fitojmë” për Kryetar Bashkie Kuçovë, me objekt të përbashkët: “ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.6.2023 të KZAZ-së nr. 64, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë” dhe rinumërim dhe rivlerësim i votave për KZAZ-në nr. 64, të gjitha QV-të, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë”.

Në kërkesën ankimore 74, datë 22.5.2023, ankuesi gjithashtu kërkon pavlefshmëri të vendimit nr. 101, datë 16.5.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë”; konstatim i pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së, ku është emëruar sekretari i KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi; pavlefshmëri e vendimit të KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, Qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 10:00 deri në orën 12:30; pavlefshmëri e pjeshme e fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashkie për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për Bashkinë Kuçovë, Qarku Berat, Kreshnik Hajdari; pavlefshmëri e veprimit juridik, formulari i dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit, dorëzuar pranë KQZ, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KAS në seancën e shqyrtimit, më datë 13.6.2023 ora 21:00 vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 67, datë 20.5.2023, të depozituar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 74, datë 22.5.2023, të depozituar nga z. Lefter Maliqi, kandidat i koalicionit “Bashkë Fitojmë” për kryetar bashkie Kuçovë.
3. Lënien në fuqi të vendimit nr. 101, datë 16.5.2023 të KZAZ nr. 64, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë”.

Kundër vendimit të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve nr. 178, datë 13.6.2023 “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 67, datë 20.5.2023 dhe nr. 74, datë 22.5.2023” pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja nr. 35 Regj. Themeltar, datë 19.6.2023, me paditës z. Lefter Maliqi dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt: Shfuqizimin/anullimin dhe/ose konstatimin e pavlefshmërisë absolute tërësore dhe/ose të pjeshme të Vendimit nr. 178, datë 13.6.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur si më poshtë:

i. Ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.5.2023 të KZAZ-së nr. 64, Bashkia Kuçovë, qarku Berat “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë” dhe

Datë: 4.7.2023 Nr: 679
Ora: 17:30



“Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, z. Kreshnik Riza Hajdari, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

duke u shpallur, unë, Lefter Maliqi, si fitues i zgjedhjeve vendore në Bashkinë Kuçovë për mandatin e kryetarit të kësaj Bashkie.

- ii. Rinumërim dhe rivlerësim i votave për KZAZ-në nr. 64, të gjitha QV-të, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.
- iii. Pavlefshmëri e vendimit nr. 101, datë 16.5.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të bashkisë Kuçovë”.
- iv. Konstatim i pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së, ku është emëruar sekretari i KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi.
- v. Pavlefshmëri e vendimit të KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, Qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 10:00 deri në orën 12:30.
- vi. Pavlefshmëri e pjeshme e fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashkie për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për Bashkinë Kuçovë, Qarku Berat, Kreshnik Hajdari.
- vii. Pavlefshmëri e veprimit juridik, formulari i dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit, dorëzuar pranë KQZ, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Më datë 30.6.2023, ora 09:00, në përfundim të seancës së shqyrtimit Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me vendimin nr. 33 vendosi rrëzimin e padisë së paditësave.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, z. Kreshnik Riza Hajdari, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI